

REPUBLIKA E KOSOVES
MUNA LIPJAN
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNA LIPLJAN

Marrëveshje

QALISE-IZLATINA-OUTDOORING
REPUBLIC OF KOSOVO
GOVERNANCE AND LOCAL GOVERNMENT DEVELOPMENT OF KOSOVO

Agjencia e Administrimit të Pushtetit Lokal
Agencija Lokalnih Samostojnih Administracija
Ministry of Local Government Administration

No. 454-248
-11-
Data 23.03.2021
E 24

Pranimja Primitives	24-03	20	21
Niveli Drejtesia	Viteti M-bj	Shtojca Dodatak	
1-454-16115			

në mes të

Ministrisë së Pushtetit Lokal

të

Republikës së Kosovës,

Komunës së

Lipjanit

dhe

Helvetas Swiss Intercooperation në Kosovë

("Palët")

në lidhje me

Grantin e performancës komunale

Në përputhje me ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës,

Në përputhje dhe në zbatim të Marrëveshjes Kornizë sa i përket Bashkëpunimit Teknik dhe Financiar si dhe Ndihmës Humanitare të arritur mes Këshillit Federal të Zvicrës dhe Qeverisë së Republikës të Kosovës, të vitit 2010;

Në përputhje me marrëveshjen me Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar, SIDA dhe HELVETAS Swiss Intercooperation në lidhje me Decentralizimin dhe Mbështetjen Komunale DEMOS II, e vitit 2018;

Në përputhje me Marrëveshjen e Grantit midis Ministrisë Norvegjeze të Punëve të Jashtme dhe HELVETAS Swiss Intercooperation në lidhje me KOS-19/0002, Decentralizimi dhe Mbështetja Komunale, e vitit 2021;

Në përputhje me Rregulloren Nr. 01/2020 për Sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit të performancës komunale, si dhe

Rregullat e Grantit për Performancë Komunale.

Kjo Marrëveshje arrihet mes të palëve:

Ministrisë së Pushtetit Lokal, me adresë në Prishtinë, ish-ndërtesa e "Rilindjes", kati 11-13, përfaqësuar nga Goran Rakić, Ministër, (këtu e tutje referuar si: "Ministria");

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, këtu e tutje referuar si "Komuna"; dhe

HELVETAS Swiss Intercooperation - Kosovë (HSIK), me seli të regjistruar në Prishtinë, rr. Nazim Gafurri 33, përfaqësuar nga Norbert A.E.M. Pijls, Drejtor i projektit për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave, faza II, këtu e tutje i referuar si "HSIK-DEMOS"

Neni 1 Përkufizimet

1. **Marrëveshje** – Marrëveshja tri palëshe për pjesëmarrje në GPK
2. **MPL** – Ministria e Pushtetit Lokal.
3. **Kontributdhënës** – Qeveria Zvicerane, Qeveria e Suedise dhe Qeveria e Norvegjisë¹;
4. **GPK** – Granti për performancën komunale;
5. **HSIK-DEMOS** - HELVETAS Swiss Intercooperation;
6. **Komunë** – Komuna e Lipjanit;

Neni 2 Qëllimi

1. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin në mes të palëve për pjesëmarrje në Grantin e Performancës Komunale (më tej GPK) dhe krijon kornizën për përkrahje financiare me qëllim të ngritjes së performancës komunale.
2. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje përbënë një nga kushtet minimale për pjesëmarrje në GPK.

Neni 3 Parimet e Përgjithshme

1. GPK është instrument financiar stimulues i përcaktuar në Ligjin për ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke zbatuar kritere të qarta, të drejta dhe transparente.
2. GPK do të bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës e përfaqësuar nga Ministria, si dhe Qeveria e Zvicrrës, Qeveria e Suedisë dhe Qeveria a Norvegjisë të përfaqësuar nga HSIK-DEMOS II.

¹ Në rast të pajtimit të donatorëve të tjerë për pjesëmarrje në GPK, shprehja e përdorur do të nënkuptoj edhe përfshirjen e tyre

3. Ndarja dhe shfrytëzimi i GPK-së bëhet në pajtim me këtë marrëveshje, legjisacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, dhe Rregullat e aprovuara të grantit të performancës komunale për vitin 2021 (më tutje Rregullat e Grantit).

Neni 4 **Të drejtat dhe obligimet e komunës**

1. Komuna ka të drejtë për pjesëmarrje në GPK në përputhje me kriteret dhe rregullat e GPK-së.
2. Komuna obligohet të shfrytëzoj dhe menaxhoj fondet e marra nga GPK në përputhje me legjisacionin e zbatueshëm në Kosovë, Rregulloren Nr.01/2020 për Sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit të performancës komunale, si dhe Rregullat e GPK-së.
3. Komuna zotohet të ofroj të dhëna të sakta dhe në kohë në lidhje me të gjitha çështjet e kërkuara për pjesëmarrje në GPK.
4. Komuna obligohet të kontrolloj dhe verifikoj të dhënat që përdoren për pjesëmarrje në GPK para dorëzimit në Ministri dhe merr përgjegjësinë e plotë për saktësinë dhe besueshmërinë e tyre.
5. Komuna zotohet të vë në dispozicion burimet njerëzore për menaxhimin efikas të mjeteve financiare të ofruara nga GPK, si dhe për pjesëmarrje në aktivitetet e HSIK-DEMOS, përfshirë pjesëmarrjen në trajnime, punëtori dhe konferenca.
6. Komuna zotohet të promovoj barazinë gjinore dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara në të gjitha aktivitetet e realizuara në përputhje me këtë Marrëveshje dhe kontratat pasuese të cilat mund të nënshkruhen si rezultat i kësaj Marrëveshje.

Neni 5 **Të drejtat dhe obligimet e Ministrisë**

1. Ministria bashkëfinancon GPK-në në vlerën prej 1,500,000.00 euro për vitin 2021, siç përcaktohet në ligjin mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2021.
2. Ministria zotohet të transferoj fondet me kohë, duke respektuar kontratat pasuese për projekte që mund të nënshkruhen si rezultat i ndarjes së GPK-së.

3. Ministria do të bashkadministroj GPK-në me ekipin e HSIK-DEMOS.
4. Ministria do të verifikojë të dhënat e raportuara nga komunat, duke vlerësuar kriteret e kërkuara të cilësisë, përkthësisht dokumentimin, vërtetësinë, saktësinë dhe kriteret e tjera siç përcaktohet me Rregulloren Nr.01/2020 për Sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit të performancës komunale si dhe Rregullat e GPK-së.
5. Ministria ndërmerr veprimet për funksionimin efikas të Komisionit të GPK-së, Grupin teknik, Komisionin e ankesave dhe Grupin përgjegjës për hartimin e rregullave të GPK-së, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ministria zotohet të veproj me transparencë të plotë dhe të bashkëpunoj me të gjitha palët e interesit për menaxhimin e GPK-së.

Neni 6 **Të drejtat dhe obligimet e HSIK-DEMOS**

1. HSIK-DEMOS do të bashkëfinancoj GPK-në në shumën prej gjithsej 2,700,000.00 euro për vitin 2021, të cilat janë kontribute të Qeverisë së Zvicrrës, Qeverisë së Suedisë dhe Qeverisë së Norvegjisë.
2. HSIK-DEMOS zotohet të transferoj fondet me kohë, duke respektuar kontratat e projekteve pasuese që mund të nënshkruhen si rezultat i kësaj Marrëveshjeje.
3. HSIK-DEMOS do të jetë pjesë e organeve përgjegjëse për zbatimin e Rregullave të GPK-së.
4. HSIK-DEMOS mund të kërkoj nga Zyra Kombëtare e Auditimit, që të kryej auditimet specifike për çfarëdo çështje që ndërlidhet me përdorimin dhe menaxhimin e buxhetit të GPK-së nga pjesa e donatorëve të cilat shfrytëzohen për investime kapitale nga Komuna konform marrëveshjes interne në mes të tyre.
5. HSIK-DEMOS në bashkëpunim me Ministrinë, mban të drejtën që të kontraktoj palë të treta të jashtme për verifikimin e cilësisë së rezultateve preliminare të tabelës së alokimit të GPK.
6. HSIK-DEMOS do t'iu ofroj komunave asistencë teknike në ngritjen e performancës në fushat e GPK, përkatësisht në fushën e qeverisjes demokratike lokale, dhe menaxhim komunal. Gjithashtu, HSIK-DEMOS mund të ofroj asistencë teknike për zhvillimin e politikave në nivel qendror dhe/apo lokal.

Neni 7
Kriteret për shfrytëzimin e GPK-së

1. Kriteret për shfrytëzimin e GPK-së përcaktohen në rregullat e aprovuara të GPK-së.
2. Për secilin projekt të financuar nga GPK nënshkruhet marrëveshje e veçantë për financim, me të cilat përcaktohen kushtet dhe procedurat për shfrytëzimin e fondeve të GPK-së.

Neni 8
Mbikqyrja dhe kontrolli

1. GPK i nënshtrohet rregullave të mbikëqyrjes dhe kontrollit konform legjislacionit në fuqi.
2. GPK mund të përfshihet në auditimin e rregullt të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
3. Shpenzimet e GPK i nënshtrohen rregullave të mbikëqyrjes së financave publike dhe mund t'i nënshtrohet auditimeve shtesë.
4. Në rast të konstatimit të shkeljeve dhe parregullsive të evidentuara nga auditimi, Ministria dhe kontributdhënësit mund të vendosin për përjashtimin e komunës nga e drejta e përfitimit të grantit për një periudhë të caktuar.
5. Ministria dhe HSIK-DEMOS mund të kërkojnë informata nga komunat për të gjitha çështjet që ndërlidhen me këtë Marrëveshje. Komuna ka përgjegjësi të vë në dispozicion të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme.
6. Komuna obligohet të arkivojë të gjitha dokumentet e ndërlidhura me këtë Marrëveshje si dhe kontratat pasuese për projekte për një periudhë jo më të shkurtër se 5 vite, pas skadimit apo ndërprerjes së saj.

Neni 9
Komunikimi në mes të palëve

1. Të gjitha palët obligohen që për çfarëdo pengese në zbatimin e kësaj Marrëveshje të njoftojnë me kohë palët e tjera.
1. Njoftimet sipas kësaj Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim dhe t'iu dërgohen palëve të tjera.

Neni 10

Ndryshimi i Marrëveshjes

1. Palët kanë të drejtën e inicimit të ndryshimit të kësaj marrëveshje.
2. Kërkesa inicuese i dorëzohet të gjitha palëve me të cilën përshkruhen propozimet për ndryshim të paktën 15 ditë më herët.
3. Për çfarëdo ndryshim të kësaj marrëveshje, palët duhet të dakordohen paraprakisht. Ndryshimet duhet të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe të përfshihen si Shtojcë e kësaj marrëveshje.
4. Asnjë veprim që ka për qëllim amendamentimin, modifikimin, ndryshimin, shpjegimin ose plotësimin e kushteve të Marrëveshjes nuk do të jetë detyruese për palët, përveç nëse dhe derisa të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të gjitha palët.

Neni 11

Ndalimi i delegimit të të drejtave dhe obligimeve palëve të treta

1. Asnjëra palë nuk mund të transferoj apo delegoj ndonjë prej obligimeve apo detyrave të saj brenda fushëveprimit të kësaj Marrëveshje, qoftë pjesërisht apo plotësisht, palëve të treta.
2. Mosshfrytëzimi i të drejtave të njëres palë për të kërkuar nga pala tjetër përmbushjen e obligimeve brenda fushëveprimit të kësaj marrëveshje, nuk konsiderohet lirim nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimeve të palës përgjegjëse.

Neni 12

Kushtet për ndërprerjen e Marrëveshjes

1. Palët kanë të drejtë ndërprerjen e marrëveshjes para fillimit të procesit të vlerësimit për Grantin e Performancës Komunale.
2. Marrëveshja nuk konsiderohet e papërmbushur, në rastet si vijon:
 - 2.1. "vis major", që nënkupton një ngjarje përtej kontrollit të palës së prekur, e cila është e paparashikueshme dhe nuk ndodh për fajin apo si rezultat i neglizhencës së asaj pale. Një ngjarje e tillë mund të përfshijë, por nuk kufizohet me, zjarret, përmbytjet, epidemitë, karantinën dhe embargot.
 - 2.2. Krijimit të rrethanave të jashtëzakonshme që i pamundësojnë palës zbatimin e marrëveshjes përkundër vullnetit të saj;

- 2.3. Vendimeve të detyrueshme të organeve më të larta se palët nënshkruese të cilat pamundësojnë ushtrimin e autorizimeve në lidhje me marrëveshjen.
- 2.4. Shkëputjes me dakordimin e plotë të palëve;

Neni 13 **Efektet e ndërprerjes së marrëveshjes**

1. Në rast të ndërprerjes së Marrëveshjes sipas kushteve të përcaktuara në nenin 12 të kësaj marrëveshje, asnjë palë nuk ka të drejtë që të kërkojë kompensim të dëmeve, kompensim material apo jo-material, apo çfarëdo kompensimi tjetër që mund të rezultojë nga ndërprerja e Marrëveshjes.
2. Shkëputja e marrëveshjes në kundërshtim me nenin 12, nuk e liron asnjë palë nga të drejtat dhe obligimet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 14 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Ligji i zbatueshëm që përdoret për këtë Marrëveshje është Ligji i Republikës së Kosovës
2. Palët dakordohen që çfarëdo mosmarrëveshje që mund të rezultojë nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë vlefshmërinë dhe anulimin e saj, do të zgjidhet përmes arbitrazhit nën patronazhin e Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e zbatueshme të arbitrazhit në këtë institucion.
3. Tribunali do të përbëhet nga pesë arbitër: një i zgjedhur nga Komuna, një i zgjedhur nga Ministria, një i zgjedhur nga HSIK-DEMOS, dhe dy të tjerë të përzgjedhur nga këta 3 arbitra.
4. Gjuha e cila do të përdoret në procedurat e arbitrazhit është gjuha të cilën e vendosë Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit, ndërsa vendi i arbitrazhit do të jetë Prishtina.

Neni 15 **Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri më 31 dhjetor të vitit 2021.

Neni 16
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje është arritur në tre (3) kopje origjinale në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze
2. Shtojca e mëposhtme është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje:

Shtojca A: Rregullat e Grantit të Performancës Komunale

1) Për dhe në emër të ministrisë



10-03-2021

[DATA DHE NËNSHKRIMI]


2) Për dhe në emër të Komunës



[DATA DHE NËNSHKRIMI]

3) Për dhe në emër të HSIK-DEMOS

11/3/2021



HELVETAS
Swiss Intercooperation

[DATA DHE NËNSHKRIMI]